



Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) është duke vazhduar me implementimin e projektit për Stabilizimin e Komuniteteve IV (EU-CSP IV), projekt i cili financohet nga BE dhe menaxhohet nga Zyra e BE-së në Kosovë. Programi EU-CSP IV do të ofroj asistencë financiare dhe teknike për fillim të bizneseve të vogla apo zgjerim të atyre ekzistuese, veçanërisht të atyre bizneseve që promovojnë dhe forcojnë riintegrimin e qëndrueshëm të anëtarëve të kthyer të komuniteteve jo-shumicë.

Po ashtu, projekti EU-CSP IV do të përkrahë edhe iniciativat e komunitetit prej të cilave komuniteti do të ketë përfitim më të gjerë. Kjo përfshin anëtarët e komuniteteve, fermerëve individualë dhe prodhuesit për të shqyrtuar mundësitë për aktivitete të përbashkëta përmes krijimit dhe mbështetjes së asociacioneve të biznesit të komuniteteve joshumicë dhe atyre ndër-etnike.

Projekti i Bashkimit Evropian për Stabilizimin e Komuniteteve (EU-CSP IV), SHTYEN AFATIN E SHPALLJES PËR THIRRJEN PËR PROJEKT PROPOZIME të ndërmarrësve të ardhshëm dhe ekzistues si dhe të grupeve e asociacioneve PËR PROJEKTE INDIVIDUALE DHE TË KOMUNITETIT. EU-CSP IV do të financojë bizneset që mund të dëshmojnë realizueshmëri dhe qëndrueshmëri ekonomike dhe që ofrojnë mundësi punësimi e krijim të të ardhurave.

Për udhëzime dhe fletë-aplikacione aplikantët e interesuar inkurajohen për të vizituar uebfaqen e IOM-it www.kosovo.iom.int si dhe të kontaktojnë (tel: 049 968 485), ku mund të merrni më shumë informata të hollësishme për procesin e aplikimit dhe zhvillim të biznes planeve, formularëve për aplikim si dhe ndihmë se si duhet të bëhet plotësimi i formularëve si dhe informata tjera për procesin dhe udhëzimet e aplikimit.

Afati i fundit për dorëzim të aplikacioneve është **30 Prill 2020** por aplikantët inkurajohen që t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre sa më parë ne email adresën: iymeri@iom.int.